

20202483225

LIGJ I HUAMARRJES SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NGA BANKA NDËRKOMBËTARE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT – BANKA BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAZIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRBALLJES URGJENTE ME COVID-19 NË MAQEDONINË E VERIUT

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit – Banka Botërore në shumën prej 90.000.000 eurosh, të paracaktuara për realizimin e Projektit të përballjes urgjente me COVID-19 në Maqedoninë e Veriut.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas sipas nenit 1 të këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e Huas që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore. Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen e Huas, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i shlyerjes së huas sipas nenit 1 të këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor me shtrirje variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas sipas nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore përqindje të njëhershme në shumë prej 0,25 % të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit – Bankës Botërore përqindje në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor, me përjashtim të periudhës prej një viti nga data e llogaritjes së kësaj përqindjeje, kur i njëjti do të jetë 0%.

Huaja sipas nenit 1 të këtij ligji do të paguhet në 18 këste gjysmëvjetore, prej të cilave 17 këste gjysmëvjetore prej 5,56 % të shumës së huas për çdo këst, ndërkaq kësti i fundit i 18 në shumë prej 5,48 % të shumës së huas. Huaja do të paguhet çdo vit më 15 mars dhe 15 shtator.

Neni 4

Shfrytëzues të mjeteve të huas sipas nenit 1 të këtij ligji janë Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan sipas nenit 1 të këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".